



Mr. Icm:	2021/ZDP/373	
Engjell:		22 12 21
Fees:	1 -	
Struktur:		
Hyreskulturo:		
Dalshkrimet:	X	
Brendshme:		

12/ZDP/VE/2021  
Datë: 22 dhjetor 2021

Në mbështetje të nenit 3.4, 15.1, 21.2 dhe 61 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Kosovës, Viti III, Nr. 28, dt. 4 qershor 2008), nenin 41 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 71 të Rregullores (AAC) NR. 05/2020 për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe themelimin e agjencisë së bashkimit evropian për sigurinë e aviacionit,

Duke vepruar në bazë të kërkesës të Limak Kosovo International Airport (më tutje LKIA) me nr. prot. 2021/AGA/363 të dt. 17 dhjetor 2021,

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr këtë:

## V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e LKIA me nr. prot. 2021/AGA/363 të dt. 17 dhjetor 2021 për zgjatjen e afatit për certifikim si e organizatë trajnuese deri në 31 mars 2022.
2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

## ARSYETIM

Më datën 17 dhjetor 2021, LKIA ka parashtruar kërkesë pranë Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për zgjatje të afatit për certifikim si organizatë trajnuese. Arsyeja e kërkesës për zgjatje mbështetet në rrethanat e krijuara pas përhapjes së pandemisë COVID-19, të cilat rrethana kanë pasur ndikim në çështje logjistike të operimeve në ANP në përgjithësi dhe në këtë vazhde edhe në procesin për certifikim si organizatë trajnuese të LKIA. Përkundër situatës të krijuar nga pandemia, të gjitha programet e trajnimeve të cilat LKIA i ofron për punonjësit e vet, janë të koordinuara dhe të aprovuara nga AAC.

Bazuar në Rregulloren (AAC) NR. 07/2020 për aftësimin profesional për punonjësit të cilët kryejnë detyra që ndikojnë në sigurinë e operimeve në aerodrome dhe certifikimin e organizatave për aftësi profesionale, e cila ka hyrë në fuqi nga 29 qershori 2021, personat juridik në mënyrë që të mund të kryejnë veprimtarinë për aftësi profesionale, duhet të marrë certifikatën për organizatën për aftësi profesionale të lëshuar nga AAC.

Nenit 71 i Rregullores (AAC) NR. 05/2020 për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe themelimin e agjencisë së bashkimit evropian për sigurinë e aviacionit, parashihet dispozitat e fleksibilitetit ku ndër të tjera lejohen të ipen përjashtime për persona juridik që i nënshtrohet akteve normative të miratuara në rast të rrethanave të paparashikueshme që mund të paraqiten.

Nga sa u tha më lartë, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, në pajtim me nenet 3.4, 15.1, 21.2 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, nenin 41 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, si dhe nenit 71 të Rregullores (AAC) NR. 05/2020 për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe themelimin e agjencisë së bashkimit evropian për sigurinë e aviacionit, kërkesës së LKIA të dt. 17 dhjetor 2021 dhe rrethanave të paparashikuara të krijuara nga përhapja e pandemisë COVID-19, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Udhëzim mbi mjetin juridik:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesë. Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të ngrit konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit.

